

URDHËR
Nr. 258, datë 15.7.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROGRAMET E KUALIFIKIMIT TË
UDHËRRËFYESVE TURISTIKË DHE PROCEDURËS PËR AKREDITIMIN E
TYRE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr. 93/2015, datë 27.7.2015, “Për turizmin”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre, sipas tekstit të rregullores dhe anekseve 1, 2 dhe 3, pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Ngarkohet Komisioni i Akreditimit, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, udhëzimi nr. 517, datë 24.1.2017, i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, “Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim”, dhe urdhri i përbashkët nr. 4792, datë 15.5.2017 i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Akreditimit të programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik”, i ndryshuar, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

RREGULLORE
**PËR PROGRAMET E KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESVE TURISTIKË DHE
PROCEDURËN PËR AKREDITIMIN E TYRE**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi dhe vendosja e standardeve të programeve të kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë në Republikën e Shqipërisë dhe miratimi i procedurës së akreditimit, duke synuar garantimin e niveleve më të larta të njohurive, aftësive profesionale dhe kompetencave të udhërrëfyesve turistikë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është parashikimi i rregullave, lidhur me:

- a) standardet dhe kriteret që duhet të përmbajnë programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik për çdo kategori; si dhe
- b) procedurën që ndiqet nga ministria përgjegjëse për turizmin për akreditimin e tyre.

Neni 3

Standardet për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik

1. Programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, për kategoritë “kombëtar”, “lokal” dhe “specialitet i veçantë”, sipas nenit 56 të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, përmbajnë kriteret e përcaktuara në anekset nr. 1, nr. 2, dhe nr. 3, bashkëlidhur rregullores.

2. Programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik ofrohen:

a) nga subjekte të licencuara në përputhje me legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional dhe nga personel me kualifikimin dhe eksperiencë për modulin përkatës;

b) duke përdorur metodologji dhe materiale mësimdhënieje të përditësuara, duke marrë parasysh nevojat e sektorit përkatës së industrisë së turizmit dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë.

3. Subjektet që ofrojnë programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik duhet të sigurohen se kursantët kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm para regjistrimit të tyre për programin e kualifikimit profesional të udhërrëfyesit turistik.

4. Subjektet që ofrojnë programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë kanë detyrimin të marrin masat, që kursantët të ndjekin rregullisht dhe të përfundojnë të gjitha modulet e planifikuara të programit të kualifikimit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e plotë gjatë moduleve të trajnimit praktik.

Neni 4

Njohja dhe certifikimi i të nxënit të mëparshëm

1. Subjektet që ofrojnë programe për kualifikimin e udhërrëfyesit turistik, njohin të nxënit e mëparshëm, të dokumentuar të kursantëve dhe nëse vlerësohet prej tyre mund bëjnë përjashtimin nga detyrimi për të ndjekur module specifike të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik në bazë individuale. Modulet e përjashtuara pas njohjes së të nxënit të mëparshëm të kursantit konsiderohen se janë përfunduar, sipas programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik që ofron subjekti.

2. Pas përfundimit të të gjitha moduleve të programit të kualifikimit, subjekti aplikon për t'u pajisur me certifikatën e udhërrëfyesit, sipas përcaktimit të nenit 57, të ligjit nr. 93/2015, të ndryshuar.

Neni 5

Procedurat për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik

1. Procesi i akreditimit të programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik bazohet në parimin e vetëvlerësimit. Çdo subjekt, që kërkon akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik të ofruara prej tij, kryen një raport vetëvlerësimi.

2. Programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë akreditohen nga një strukturë e posaçme, e ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe e miratuar me urdhër ministri, këtu e në vijim “Komisioni i Akreditimit”. Në përfundim të procesit të akreditimit, ministria përgjegjëse për turizmin miraton ose jo programin e kualifikimit.

3. Subjekti që kërkon akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik që ai ofron, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin raportin e vetëvlerësimit ose një raport vetëvlerësimi të plotësuar *online*, si dhe dokumentet provuese, përfshirë kurrikulat e detajuara që ofron subjekti, kualifikimin dhe eksperiencën e personelit trajnues. Për turet demonstruese gjatë trajnimit praktik në terren, trajnerët duhet të jenë udhërrëfyes turistikë të certifikuar.

4. Komisioni i Akreditimit shqyrton raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentet provuese jo më vonë se 7 ditë pune nga dita e aplikimit.

5. Në rast të mungesave, pasaktësive në dokumentacion, të mosplotësimit të standardeve sipas pikës 3, të këtij neni, Komisioni i Akreditimit i kërkon subjektit plotësimin e mangësive të konstatuara brenda 15 ditë pune.

6. Pas plotësimit të mangësive nga subjekti, brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, Komisioni i Akreditimit, brenda 3 ditë pune, përgatit një raport, me rekomandime për dhënien ose refuzimin e akreditimit, si dhe evidenca e gjetjeve. Raporti, përveç rekomandimeve dhe gjetjeve përmban, nëse ka, rekomandime për subjektin në lidhje me masat që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programit të kualifikimit që ai ofron. Ato janë këshillimore dhe subjekti ka liri veprimi në lidhje me mënyrën e trajtimit të rekomandimeve.

7. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit të kërkuar, brenda afatit të parashikuar sipas pikës 5 të këtij neni, Komisioni i Akreditimit, merr vendimin për refuzimin e aplikimit.

8. Ministri përgjegjës për turizmin, bazuar në rekomandimin e Komisionit të Akreditimit, miraton akreditimin ose mosakreditimin e programit të kualifikimit të ofruar nga subjekti kërkuar.

9. Programi i kualifikimit i akredituar për udhërrëfyesit turistikë është i vlefshëm për një afat 5-vjeçar.

10. Përgjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit, subjektet kontrollohen nga ministria përgjegjëse për turizmin të paktën një herë në vit për vazhdimësinë e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara, sipas pikës 2, të nenit 3, dhe pikës 3, të nenit 5, të këtij urdhri dhe rekomandimeve të dhëna në raport. Në rast të verifikimit të mangësive të konsiderueshme, të cilat, sipas vlerësimit të Komisionit të Akreditimit nuk mund të ndreqen, i propozohet ministrit përgjegjës, shfuqizimin e akreditimit.

11. Përjashtohen nga detyrimi për të akredituar programet e kualifikimit për udhërrëfyes turistik sipas këtij urdhri institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe të arsimit të lartë. Diplomat e lëshuara nga këto institucione njihen nga Komisioni i Standardizimit të veprimtarive turistike si dokumente kualifikimi profesional për udhërrëfyesin turistik, me kusht që programet e tyre të përmbajnë kriteret për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet përkatëse të kualifikimit sipas anekseve nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3.

Neni 6

Komisioni i Akreditimit të programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik

1. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Komisionit të Akreditimit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Komisioni i Akreditimit asistohet nga sekretaria teknike, që përbëhet nga specialistë të drejtorisë përgjegjëse për standardet në turizëm.

3. Komisioni i Akreditimit mblidhet nga kryetari çdo herë që ka një kërkesë nga një subjekt për akreditimin e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik që ai ofron, bazuar në raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentet provuese, të paraqitura nga vetë subjekti.

4. Sekretaria teknike njofton kryetarin e Komisionit të Akreditimit për kërkesat e ardhura për akreditim dhe kryetari vendos për datën e mbledhjes.

5. Data e mbledhjes u njoftohet anëtarëve të Komisionit të Akreditimit brenda 5 ditëve nga marrja e çdo kërkesë. Sekretaria teknike është përgjegjëse për shpërndarjen e materialeve përkatëse të gjithë anëtarët e Komisionit të Akreditimit.

6. Komisioni i Akreditimit merr vendimet e tij me shumicën e votave, kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve. Në rast barazie votash, përcaktuese është vota e kryetarit të Komisionit të Akreditimit. Komisioni i Akreditimit përgatit një raport për çdo kërkesë, i cili përfshin evidencën e gjetjeve, vlerësimin e përmbushjes së standardeve për akreditimin e programeve të kualifikimit dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e cilësisë së programit, nëse ka.

7. Në çdo rast, vendimi i Komisionit të Akreditimit për dhënien ose mosdhënien e akreditimit të programit të kualifikimit, duhet të jetë i arsyetuar dhe i bazuar ligjërisht.

8. Për çdo kërkesë që shqyrtohet, Komisioni i Akreditimit harton procesverbalin përkatës, i cili duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Raporti i Komisionit të Akreditimit dhe procesverbali përkatës i dërgohet menjëherë ministrit, për miratimin e vendimit lidhur me akreditimin ose jo të programit të kualifikimit.

Neni 7 Ankimi

Ndaj aktit të ministrit përgjegjës për turizmin, për miratimin ose jo të akreditimit të programit të kualifikimit të ofruar nga subjekti kërkuar, subjekti ka të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

ANEKSI NR. 1 STANDARDET DHE KRITERET E PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK KOMBËTAR

Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik kombëtar hartohet në përputhje me standardin SSH EN 15565 “Shërbimet e turizmit – Kërkesat për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të udhërrëfyesve turistikë profesionalë”¹, i cili specifikon kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet përkatëse të kualifikimit.

Në program vihet theksi te rëndësia e ofrimit të një shërbimi cilësor nga ana e udhërrëfyesve turistikë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky standard specifikon kompetencat dhe qartëson platformën e duhur të trajnimeve, rekomandon aftësitë dhe njohuritë e përgjithshme dhe specifike që duhet të zotërojnë një udhërrëfyes turistik dhe përcakton trajnimin praktik, si dhe procedurat e vlerësimit, të cilave duhet t’u nënshtrohet udhërrëfyesi turistik kombëtar. Ky standard përcakton, gjithashtu, normat dhe kushtet e punës për udhërrëfyesin turistik.

Kualifikimi profesional i udhërrëfyesit turistik kombëtar duhet të mbulojë dy fusha kryesore aftësimi profesional, të ndara si më poshtë:

- a) Njohuri mbi Republikën e Shqipërisë;
- b) Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit.

Programi mësimor është llogaritur për jo më pak se 600 orë mësimi (të ndara në: teori 180 orë, praktikë 240 orë dhe autodidakt 180 orë).

Autodidakt nënkupton procesin e studimit personal dhe punë kërkimore.

Një orë mësimi (teori, praktikë, autodidakt) është e barasvlershme me 1 kredit. Numri total i krediteve për plotësimin e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit kombëtar është 600.

Subjekti që ofron programin e kualifikimit profesional vlerëson përvetësimin e njohurive të fituara nga ky program kualifikimi nëpërmjet organizimit të testimit me shkrim dhe demonstrimit praktik të udhërrëfimit.

A. Njohuri mbi Republikën e Shqipërisë

Programi mësimor duhet të jetë i përshtatur në mënyrë që kandidati për udhërrëfyes turistik kombëtar të jetë i përgatitur për të prezantuar me saktësi historinë, trashëgiminë kulturore e mjedisore të vendit dhe të prezantojë me vërtetësi aktualitetin.

1. Mjedisi fizik dhe natyra

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

2. Gjeografia humane dhe zhvillimi shoqëror e urban

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

3. Arkeologjia, prehistoria dhe antikiteti Shqipërisë

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

4. Historia e Shqipërisë

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

5. Diversiteti kulturor

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

¹Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit informon ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për çdo ndryshim që mund të pësojë standardi në vite.

6. Arti dhe arkitektura

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

7. Kohët moderne

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

8. Praktika dhe mësimi në terren

(20 orë praktikë në terren me profesorin/trajnerin + 20 orë praktikë personale)

B. Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit

1. Njohuri dhe aftësi profesionale të udhërrëfyesit turistik

Aftësi biznesi dhe kushtet e punës

(40 orë leksion + 40 autodidakt)

2. Ndihma e shpejtë

2.1 Certifikatë për trajnimin e ndihmës së shpejtë, e lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose një subjekt tjetër i ngjashëm.

3. Praktikë

(136 orë praktikë në terren me profesorin/trajnerin + 64 orë punë kërkimore)

Për turet demonstruese gjatë trajnimit praktik, trajnerët duhet të jenë udhërrëfyes turistikë të certifikuar.

ANEKSI NR. 2

STANDARDET DHE KRITERET E PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK LOKAL

Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal hartohet në përputhje me standardin SSH EN 15565 “Shërbimet e turizmit – Kërkesat për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të udhërrëfyesve turistikë profesionalë”², i cili specifikon kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet përkatëse të kualifikimit.

Në program theksohet rëndësia e një udhërrëfyesi turistik për një zonë të veçantë të territorit të Republikës së Shqipërisë (sipas zonave të përcaktuara në pikën “b” të nenit 4 të kësaj rregulloreje), me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor turistik.

Ky standard specifikon kompetencat dhe qartëson platformën e duhur të trajnimeve, rekomandon aftësitë dhe njohuritë specifike, që duhet të zotërojnë një udhërrëfyes turistik lokal, dhe përcakton trajnimin praktik dhe procedurat e vlerësimit të cilave duhet t’u nënshtrohet udhërrëfyesi turistik lokal. Ky standard përcakton, gjithashtu, normat dhe kushtet e punës për udhërrëfyesin turistik lokal.

Kualifikimi profesional i udhërrëfyesve turistikë lokalë duhet të mbulojë dy fusha kryesore aftësimi profesional të ndara si më poshtë:

A. Njohuri mbi zonën e veçantë;

B. Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit.

Ky program është llogaritur për jo më pak se 320 orë mësimi (teori 96 orë, praktikë 128 orë, autodidakt 96 orë).

Autodidakt nënkupton procesin e studimit privat dhe detyrave.

Një orë mësimi (teori, praktikë, autodidakt) është e barasvlershme me 1 kredit. Numri total i krediteve për plotësimin e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit lokal 320.

Subjekti që ofron programin e kualifikimit profesional vlerëson përvetësimin e njohurive të fituara nga ky program kualifikimi nëpërmjet organizimit të testimit me shkrim dhe demonstrimit praktik të udhërrëfimit.

A. Njohuri mbi zonën e veçantë

²Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit informon ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për çdo ndryshim që mund të pësojë standardi në vite.

Programi mësimor duhet të jetë i përshtatur në mënyrë që kandidati për udhërrëfyes turistik lokal të jetë i përgatitur për të interpretuar me saktësi trashëgiminë kulturore e mjedisore të zonës dhe të prezantojë me vërtetësi aktualitetin.

1. Mjedisori fizik dhe natyra në zonën e veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

2. Gjeografia humane dhe zhvillimi shoqëror e urban në zonën e veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

3. Arkeologjia, prehistoria dhe antikiteti në zonën e veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

4. Historia e përgjithshme e zonës së veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

5. Diversiteti kulturor i zonës së veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

6. Arti dhe arkitektura në zonën e veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

7. Kohët moderne

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

8. Praktika dhe mësimi në terren

(10 orë praktikë në terren me profesorin/trajnerin + 10 praktikë personale)

9. Njohuri të përgjithshme për Shqipërinë

(6 orë leksion)

B. Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit

1. Njohuri dhe aftësi profesionale të udhërrëfyesit turistik

Aftësi biznesi dhe kushtet e punës

(26 orë leksion + 20 orë autodidakt)

2. Ndihma e shpejtë

2.1 Certifikatë për trajnimin e ndihmës së shpejtë, e lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose një subjekt tjetër i ngjashëm.

3. Praktikë

(70 orë praktikë në terren me profesorin/trajnerin + 38 orë punë kërkimore)

Për turet demonstruese gjatë trajnimit praktik, trajnerët duhet të jenë udhërrëfyes turistikë të certifikuar.

ANEKSI NR. 3

**STANDARDET DHE KRITERET E PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË
UDHËRRËFYESIT TURISTIK TË SPECIALITETIT TË VEÇANTË**

Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik të specialitetit të veçantë hartohet në përputhje me standardin SSH EN 15565 “Shërbimet e turizmit – Kërkesat për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të udhërrëfyesve turistikë profesionalë”³, i cili specifikon kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë të specialitetit të veçantë dhe programet përkatëse të kualifikimit.

Në program vihet theksi në rëndësinë e një udhërrëfyesi turistik për një veprimtari të veçantë, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor turistik.

Ky standard specifikon kompetencat dhe qartëson platformën e duhur të trajnimeve, rekomandon aftësitë dhe njohuritë specifike që duhet të zotërojë një udhërrëfyes turistik i specialitetit të veçantë dhe përcakton trajnimin praktik dhe procedurat e vlerësimit, të cilave duhet t’u nënshtrohet udhërrëfyesi turistik i specialitetit të veçantë. Ky standard përcakton, gjithashtu, normat dhe kushtet e punës për udhërrëfyesin turistik të specialitetit të veçantë.

³Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit informon ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për çdo ndryshim që mund të pësojë standardi në vite.

Kualifikimi profesional i udhërrëfyesit turistik të specialitetit të veçantë duhet të mbulojë dy fusha kryesore aftësimi profesional të ndara, si më poshtë:

A. Njohuri mbi veprimtarinë/specialitetin e veçantë;

B. Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit .

Ky program është llogaritur për jo më pak se 320 orë mësimi (teori 96 orë, praktikë 128 orë, autodidakt 96 orë).

Autodidakt nënkupton procesin e studimit privat dhe detyrave. Një orë mësimi (teori, praktikë, autodidakt) është e barasvlershme me 1 kredit. Numri total i krediteve për plotësimin e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit të specialitetit të veçantë 320.

Subjekti që ofron programin e kualifikimit profesional vlerëson përvetësimin e njohurive të fituara nga ky program kualifikimi nëpërmjet organizimit të testimit me shkrim dhe demonstrimit praktik të udhërrëfimit.

A. Njohuri mbi veprimtarinë/specialitetin e veçantë

Programi mësimor duhet të jetë i përshtatur në mënyrë që kandidati për udhërrëfyes turistik të specialitetit të veçantë të zotërojë njëkohësisht njohuri të mira dhe aftësi fizike për t'i ofruar turistit, në kushte të larta sigurie, një eksperiencë unike lidhur me temën/objektin e veçantë, duke interpretuar me saktësi të gjithë informacionin rreth kësaj teme/objekti dhe duke prezantuar me vërtetësi aktualitetin.

Për udhërrëfyesit turistikë të turizmit të aventurës, programi duhet të jetë i përshtatur për t'i ofruar udhërrëfyesit turistik njohuritë dhe aftësitë teknike minimale sipas standardit SSH ISO 21102 “Turizmi i Aventurës – Udhëheqësit – Kompetencat e personelit”*.

B. Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit

1. Njohuri dhe aftësi profesionale të udhërrëfyesit turistik

Aftësi biznesi dhe kushtet e punës

(20 orë leksion dhe 26 orë autodidakt)

2. Ndihma e shpejtë

2.1 Certifikatë për trajnimin e ndihmës së shpejtë, e lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose një subjekt tjetër i ngjashëm.

3. Praktikë

(70 orë praktikë në terren me profesorin/trajnerin + 58 orë praktikë personale).

Për turet demonstruese gjatë trajnimit praktik, trajnerët duhet të jenë udhërrëfyes turistikë të certifikuar.